



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/15
Datë: 22.07.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 korrik 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Rimëkëmbjen Ekonomike - COVID 19.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Avdullah HOTI


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/15

Datë: 22.07.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 korrik 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim lidhur me financimin e Projektit Emergjent COVID -19 për Kosovën.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/15
Datë: 22.07.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 korrik 2020, merr këtë:

V E N D I M

**Për themelimin e Ekipit Nacional për hartimin e Strategjisë për Specializim të Mençur
(Smart Specialisation)**

1. Ekipi Nacional për hartimin e Strategjisë për Specializim të Mençur përbëhet nga:
 - 1.1. Vedat Sagonjeva, Drejtor i Zyrës për Planifikim Strategjik, ZKM, kryesues;
 - 1.2. Agim Kukaj, Departamenti i Postë Telekomunikacionit dhe TIK, Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit - zëvendës kryesues;
 - 1.3. Jeton Karaqica, Departamenti për Ekonomi dhe Tregti, ZKM - anëtar;
 - 1.4. Qamile Sinanaj, Departamenti për Arsimit të Lartë, Ministria e Arsimit dhe Shkencës - anëtare;
 - 1.5. Valbona Dushi, Departamenti për Industri, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - anëtare;
 - 1.6. Sytrime Dervisholli, Departamenti për Tregti, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - anëtare;
 - 1.7. Laura Zherka, Departamenti për Inovacion, Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit - anëtare;
 - 1.8. Qëndresa Shala, Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) - anëtare;
 - 1.9. Fetah Podvorica, Akademia e Shkencës dhe Arteve të Kosovës - anëtar;
 - 1.10. Faton Berisha, Universiteti i Prishtinës, anëtar;
 - 1.11. Edmond Hajrizi, Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT) - anëtar;
 - 1.12. Berat Rukiqi, Oda Ekonomike e Kosovës, anëtar;
 - 1.13. Dominik Deda, Shoqata për Teknologji të Informacionit dhe të Komunikimit të Kosovës (STIKK) - anëtar;
 - 1.14. Uranik Begu, Qendra e Kosovës për Inovacion (ICK) - anëtar;
 - 1.15. Astrit Rexhaj, Klasteri i Industrisë së Metalit, Energjisë së Ripërtërishme dhe Inovacionit të Kosovës - anëtar.
2. Ekipi Nacional është përgjegjës për hartimin e Strategjisë për Specializim të Mençur, në përputhje me udhëzimet e Joint Research Centre të Komisionit Evropian.
3. Kryesuesi i Ekipit, sipas nevojës, për të mbështetur punën e Ekipit, fton si anëtarë ekspertë nga institucionet publike, akademike dhe shoqëria civile si dhe ekspertë të tjerë që kanë kompetencë profesionale për temat përkatëse.

4. Kryesuesi i Ekipit, mund të propozojë themelimin dhe përbërjen e grupeve tematike për fusha të caktuara të Strategjisë.
5. Zyra për Planifikim Strategjik, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, e kryeson dhe mbështetë punën e Ekipit Nacional dhe grupeve tematike përgjatë tërë procesit, në mbledhjen e të dhënave, përgatitjen e analizave dhe përgatitjen e dokumenteve të nevojshme, sipas nevojës.
6. Obligohen të gjitha institucionet kompetente për zbatimin e këtij vendimi.
7. Me këtë vendim shfuqizohet Vendimi Nr. 02/60, i datës 07.08.2018.
8. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Avdullah HOTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/15

Datë: 22.07.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 dhe nenin 7 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 korrik 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Plani i Veprimit 2020-2021 për zbatimin e Strategjisë për Përmirësimin e Planifikimit dhe Koordinimit të Politikave në Kosovë (Sistemi i Planifikimit të Integruar) 2017-2021.
2. Obligohen të gjitha ministratë dhe institucionet tjera t'i kryejnë obligimet e parapara në zbatim të këtij Plani të Veprimit për periudhën 2020-21 të Strategjisë për Përmirësimin e Planifikimit dhe Koordinimit të Politikave (Sistemi i Planifikimit të Integruar) 2017-2021.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/15

Datë: 22.07.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 59 pika 5 dhe 9 të Ligjit nr. 03/L-163 për Miniera dhe Minerale i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-158, duke u bazuar në nenin 4 dhe nenin 7 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 korrik 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e katër (4) anëtarëve të Bordit në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale në këtë përbërje:
 - 1.1. Lulzim Ejupi, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme, kryesues;
 - 1.2. Izedin Bytyqi, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Infrastrukturës, anëtar;
 - 1.3. Burim Rreci, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, anëtar;
 - 1.4. Mentor Sylmeta, U.D. Sekanëtar i Përgjithshëm i Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit;
 - 1.5. Edi Gusia, Kryeshefe e Agjencisë për Barazi Gjinore/ZKM, anëtare.
2. Obligohet Komisioni ad hoc nga pika 1. e këtij vendimi që t'i kryej punët dhe detyrat në pajtim me Ligjin nr. 03/L-163 për Miniera dhe Minerale, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-158.
3. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që brenda shtatë ditësh të publikoj shpalljen e konkursit për pozitat e lira në Bordin e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/15
Datë: 22.07.2020

Në mbështetje të nenit 17 paragrafi 1, të nenit 92 paragrafi 4, dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 7 paragrafi 5, të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 korrik 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet propozimi i Ministrisë së Financave për të kërkuar nga Presidenti i Republikës së Kosovës dhënien e autorizimit Ministres së Financave për nënshkrimin e Amendamentit Nr. 1 të Marrëveshjes mes Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Qeverisë Hungareze, lidhur me Programin Kornizë për Bashkëpunim Financiar.
2. Qeveria e Republikës së Kosovës i rekomandon Presidentit të Republikës së Kosovës dhënien e autorizimit Ministres së Financave për nënshkrimin e marrëveshjes nga pika 1. e këtij vendimi, në përputhje me Ligjin për Marrëveshjet Ndërkombëtare.
3. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/15

Datë: 22.07.2020


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 korrik 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Grupi Punues për hartimin e modaliteteve dhe skenareve për çështje të reformës në sistemin e Drejtësisë me qëllim të adresimit të Llogaridhënjes duke përfshirë edhe Vettingun, (në tekstin e mëtejme Reforma) në këtë përbërje:
 - 1.1 Një (1) përfaqësues nga Zyra e Kryeministrit;
 - 1.2 Një (1) përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë;
 - 1.3 Pesë (5) përfaqësues nga organizatat e Shoqërisë Civile;
 - 1.4 Një (1) përfaqësues nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës;
 - 1.5 Një (1) përfaqësues nga Këshilli Prokurorial i Kosovës;
 - 1.6 Një (1) përfaqësues nga Policia e Kosovës;
 - 1.7 Një (1) përfaqësues nga Agjencia e Kosovës për Inteligjencë;
 - 1.8 Një (1) përfaqësues nga Oda e Avokatëve të Kosovës, si dhe
 - 1.9 Përfaqësues nga Grupi i Ekspertëve të pavarur sipas pikës 1 të vendimit nr. 08/04 të datës 28.02.2020;
 - 1.10 Përfaqësues tjerë nga sistemi i drejtësisë.
2. Ftohen në rolin e mbështetës përfaqësues nga:
 - 2.1. Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë;
 - 2.2. Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës;
 - 2.3. Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar;
 - 2.4. Ambasada e Gjermanisë;
 - 2.5. Ambasada e Italisë;
 - 2.6. Ambasada e Francës;
 - 2.7. Përfaqësues nga Misioni i OSBE; si dhe
 - 2.8. Përfaqësues tjerë nga Shoqëria Civile.
3. Grupi punues do të ketë mandat për çështjet si në vijim:
 - 3.1. Të ofroj një studim kuptimplotë, të thelluar dhe të argumentuar mbi mundësinë e fillimit të një procesi të Reformës në sistemin e drejtësisë së Republikës së Kosovës;

- 3.2. Të ofroj një pasqyrë të qartë të skenarëve me të cilët mund të bazohet reforma në sistemin e drejtësisë, në dritën e së drejtës kushtetuese dhe sistemit ligjor të Republikës së Kosovës, parimeve ndërkombëtare të pavarësisë, paanshmërisë, integritetit dhe profesionalizmit të funksionit gjyqësor e prokurorial, të së drejtës për të drejtat e njeriut kryesisht të bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe të ligjeve pozitive duke përfshirë por pa u kufizuar në forumet e ekspertëve siç janë Komisioni i Venecias dhe Këshilli i Evropës në përgjithësi;
 - 3.3. Të përcaktoj elementet e reformës në sistemin e drejtësisë, sipas secilit skenar/alternativë të identifikuar, dhe të identifikoj rreziqet, mundësitë, përparësitë dhe dobësitë e secilit skenar të studiuar;
 - 3.4. Të përcaktoj metodën e përfshirjes konstitutive të elementit ndërkombëtar në procesin e reformës, dhe mënyrën se si duhet ushtruar përpjekja për të ndërtuar konsensusin parlamentar për një ndryshim të tillë madhor;
 - 3.5. Të identifikoj rastet e suksesshme të krahasueshme, dhe t'i sugjeroj/pasqyroj elementet e dobishme që mund të përfshihen në reformë në rastin e Kosovës.
4. Grupi punues, deri me datë 30 tetor 2020, (me mundësi të zgjatjes për 1 muaj), Qeverisë dhe Ministrisë së Drejtësisë do t'i paraqesë një raport me skenar/alternativa për Reformën në Sistemin e Drejtësisë dhe opcionet që duhet ndjekur për realizimin e reformës në sistemin e drejtësisë të mbështetur në objektivitet, integritet profesional dhe më së shumti në parime që e bëjnë reformën objektive, transparente dhe të besueshme.
 5. Grupi Punues do të kryej këtë shërbim pro bono (pa asnjë kompensim financiar). Ai do të jetë plotësisht i pavarur në dhënien e vlerësimit dhe nuk do të ndikohet nga pritjet apo perspektivat e askujt në dhënien e ekspertizës së saj. Ai funksionon mbi premisën e punës vullnetmirë, në të mirë të interesit publik, e të bazuar në etikën profesionale.
 6. Mbledhjet e grupit punues do t'i thërras Kryesuesi, dhe mund të ftohen edhe ekspertë të vendeve që kanë kaluar procesin e reformave.
 7. Raporti përfundimtar mbi skenarët e Reformës në Sistemin e Drejtësisë, si dhe rekomandimet e dala nga procesi i Rishikimit Funkcional të Sektorit të Sundimit të Ligjit do të shfrytëzohet si bazë mbi të cilin pastaj Qeveria dhe Ministria e Drejtësisë, në koordinim me akterët tjerë si dhe partnerët strategjik do të procedojë tutje me reformë.
 8. Materialet e punës dhe raportet e Grupit të Ekspertëve të pavarur sipas vendimit Nr. 08/04 të datës 28.02.2020, të jenë të qasshme për realizimin e objektivave sipas këtij vendimi.
 9. Obligohet Ministria e Drejtësisë që grupit punues t'i ofroj mbështetjen e nevojshme teknike.
 10. Me këtë vendim shfuqizohet vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.08/04, datë 28.02.2020, si dhe Vendimi nr. 05/37 datë 30.05.2020.
 11. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Avdullah HOTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/15
Datë: 22.07.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 3, 4, 9, 10, 44 dhe nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 korrik 2020, merr këtë:

V E N D I M P R E L I M I N A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme/Ndërtesës-Lokaleve Afariste të cilat janë nën menaxhimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) e të cilat preken nga realizimi i projektit "Ndërtimi i Sheshit të Qytetit" në Obiliq, sipas tabelës të përshkruar nga evidencat kadastrale përkatëse për titullarët e pronave të paluajtshme, pozitën e tyre në kuadër të projektit të interesit publik si dhe sipërfaqeve të tyre, e cila tabelë është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Obligohet Departamenti i Shpronësimit (MEA) që brenda 5 (pesë) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij vendimi preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej 10 ditëve të punës pas miratimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Kosovës, si dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.
3. Kundër këtij vendimi apo cilës do pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në Gjykatën Kompetente, subjekti kërkues dhe cili do person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky vendim.
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit, Ministria e Financave dhe Komuna e Obiliqit.
5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/15
Datë: 22.07.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 3, 4, 8, 44 dhe nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 korrik 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet shqyrtimi i mëtejshëm i kërkesës për shpronësim për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga ndërtimi i "Poligonit Kryesor të Trajnimeve" për nevoja të FSK-së, Zonat Kadastrale: Babaj i Bokës, Shishman i Bokës, Popoc, Ponoshec, Cerret dhe Devë të Komunës së Gjakovës, sipas tabelave të përshkruar nga evidencat kadastrale përkatëse për titullarët e pronave të paluajtshme, pozitën e tyre në kuadër të projektit të interesit publik si dhe sipërfaqeve të tyre, të cilat tabela janë pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Vlera e kompensimit të pronave do të caktohet nga Ministria e Financave, konform Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2015 "Për zbatimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përlogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin".
3. Për zbatimin e këtij vendimi, obligohen Departamenti i Shpronësimit/Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit (MEA), Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Financave.
4. Pagesa e shpronësimit të pronave do të bëhet nga buxheti i Subjektit Kërkues/Ministria e Mbrojtjes.
5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/15
Datë: 22.07.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063 dhe me Ligjin Nr. 05/L-007, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 korrik 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Ri-aprovohet Raporti Vjetor Financiar për vitin 2019.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Raportin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedoj Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Tërhiqet nga procedura e Kuvendit të Republikës së Kosovës Raporti Vjetor Financiar për vitin 2019 i aprovuar me Vendimin e Qeverisë Nr. 06/15 datë 23.03.2020, i proceduar në Kuvend me Vendimin e Qeverisë Nr. 02/03 datë 06.06.2020.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Pasqyrat financiare për vitin 2019, janë aprovuar në Qeveri me Vendimin Nr. 06/15, datë 23.03.2020, dhe konfirmimit me Vendimin e Qeverisë Nr.02/03 datë 06.06.2020 dhe dorëzuara në Kuvend sipas afateve ligjore. Të njëjtat mund të rishikohen derisa nuk është përmbyllur auditimi dhe nuk është lëshuar opinionimi përkatës në pajtim me legjislacionin në fuqi.


Gjatë fazës së auditimit dhe shqyrtimit të pasqyrave financiare vjetore nga Zyra Kombëtare e Auditimit, janë ngritur disa çështje që lidhen me trajtimin e të hyrave vetanake të bartura, përkatësisht burimit të financimit, sipas kërkesave të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit për sektorin publik (SNKSP) të aplikueshme, të cilat me ligjin e buxhetit (tabelën 1) janë trajtuar si plan për pranime nga të hyrat e bartura, si burim i financimit të brendshëm për vitin 2019.

Me rastin e ri-aprovimit të këtyre pasqyrave financiare vjetore (2019), kemi të bëjmë vetëm me shpalosje dhe shënime plotësuese të të dhënave për buxhetin e planifikuar, përkatësisht aspektit të paraqitjes së burimit të financimit dhe refleksioneve përkatëse, ndërsa nuk ka ndryshim të pozicioneve të raportuara me raportin vjetor 2019. Gjithashtu, janë adresuar edhe disa çështje të natyrës teknike dhe jo materiale në kuadër të raportit vjetor financiar për vitin 2019, i cili në tërësinë e tij konsiderohet i rishikuar.

Ndërsa, të dhënat për ekzekutimin e buxhetit dhe raportimit të pozicioneve përkatëse nuk ka ndryshim meqë transaksionet janë raportuar sipas kërkesave të LMFPF dhe SNKSP.

Pas miratimit të raportit të rishikuar në pozicionet e lartpërmendura, i njëjti i plotë si raport i dorëzohet përsëri Kuvendit të Kosovës si dhe Zyrës Kombëtare të Auditimit, i cili merret për bazë nga ZKA si raport final mbi të cilin edhe lëshon raportin dhe opinionin e Auditimit.

Avdullah HOTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/15
Datë: 22.07.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 të Ligjit Nr. 04/L-198 për Tregtinë e Mallrave Strategjike, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 korrik 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Ndryshohet dhe plotësohet Vendimi i Qeverisë Nr. 04/90, i datës 19.02.2019, për formimin e Komisionit për kontrollin e tregtisë me mallra strategjike.
2. Ndryshohet paragrafi 1 i vendimit bazë, ashtu që z. Petrit Prekazi caktohet anëtar, ndërsa z. Dren Terziqi emërohet zëvendës anëtar i këtij komisioni.
3. Ky vendim është pjesë përbërës i Vendimit Nr. 04/90, të datës 19.02.2019.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/15
Datë: 22.07.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 korrik 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Z. Arben Çitaku, në përputhje me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 03/03, të datës 19.02.2020, i emëruar me Vendimin e Qeverisë Nr. 06/151, të datës 02.08.2017 si Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ri caktohet në pozitën Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.
2. I ri-caktuari nga pika 1. e këtij vendimi kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me legjislacionin në fuqi deri në përfundimin e mandatit sipas Vendimit të Qeverisë Nr. 06/151, të datës 02.08.2017, ligjit dhe akteve nënligjore që rregullojnë marrëdhënien e punës në shërbimin civil.
3. Obligohet Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/15
Datë: 22.07.2020


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 5 dhe 6 të Ligjit Nr. 06/L-059 për Kompleksin Memorial "Adem Jashari" në Prekaz, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 korrik 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Komiteti Ndërministror për përzgjedhjen e projektit për Kompleksin Memorial "Adem Jashari" në Prekaz, në këtë përbërje:
 - 1.1. Kryesues i Komitetit - z. Besnik Tahiri, Zëvendëskryeministër i Parë;
 - 1.2. Anëtar i Komitetit - Ministrija e Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
 - 1.3. Anëtar i Komitetit - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë;
 - 1.4. Anëtar i Komitetit - Ministri i Infrastrukturës;
 - 1.5. Anëtar i Komitetit - Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale;
 - 1.6. Anëtar i Komitetit - Përfaqësues nga Familja Jashari;
 - 1.7. Anëtar i Komitetit - Drejtori i Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës;
 - 1.8. Anëtar i Komitetit - Drejtori i Muzeut të Kosovës;
 - 1.9. Anëtar i Komitetit - Drejtori i Institutit të Historisë;
 - 1.10. Anëtar i Komitetit - Drejtori i Institutit Albanologjik;
 - 1.11. Anëtar i Komitetit - z. Bekim Jashari, Kryetar i Komunës së Skenderajt;
 - 1.12. Anëtar i Komitetit - Përfaqësues nga Shoqata e Arkitektëve; dhe
 - 1.13. Anëtar i Komitetit - Përfaqësues nga OVL e UÇK-së.
2. Komiteti Ndërministror nga pika 1. e këtij vendimi Obligohet t'i kryej detyrat e përcaktuara me Ligjin Nr. 06/L-059 për kompleksin memorial "Adem Jashari" në Prekaz dhe legjislacionin tjetër përkatës.
3. Shfuqizohet vendimi i Qeverisë nr. 05/87 i datës 29.01.2019.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Avdullah HOTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë